



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:195036

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05612365

C.nr.1503/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit B.D., nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson e autorizuar V.Rr., me objekt kontesti kompensimi i tre pagave përcjellëse me rastin pensionimit, vlera e kontestit 1,956.15 euro, jashtë seance me datë 24.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.D., nga Gjakova me të cilën ka kërkuar që të *“Detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.D., nga Gjakova, në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të ia paguajë shumën prej 1,956.15 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive”*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi B.D., nga Gjakova në këtë gjykatë me datë 29.08.2023, përmes të autorizuarit të tij Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, duke theksuar se paditësi ka qenë i punësuar si drejtor në SHFMU “...” në fshatin Hereç, Komuna e Gjakovës. I njëjti me datë 20.07.2023, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare është pensionuar me Vendimin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës me numër 399774 i datës 05.06.2023. E paditura nuk e ka përmbushur detyrimin kontraktues sipas nenit 35 pika 9 e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë numër 01/B me numër të protokollit 105 të datës 22.01.2021 nënshkruar mes MASHT dhe SBASHK, sipas të cilës obligohet që punëtorëve që punojnë në institucione arsimore, që dalin në pension të i paguajnë tre paga përcjellëse me rastin e pensionimit, andaj paditësi ka parashtruar padi ku ka kërkuar të detyrohet e paditura të ia paguajë shumën prej 1,956.15 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës V.Rr., këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 06.10.2023 me të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit. Tutje ka cituar dispozitën e nenit 46 par.2 të KKAK-së ku shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, për çka ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në Kontratë sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjetet financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive për pagesën e këtij kompensimi. Ka shtuar se duke marrë parasysh se nga data 21.11.2022 është bërë shkëputja e njëanshme e Kontratës Kolektive, ka konsideruar se kërkesat e paraqitura pas kësaj date nuk prodhojnë efekt juridik dhe si të tilla duhet të refuzohen. Ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Vendimi 01 Nr.112/02-18577 i lëshuar nga e paditura me datës 12.07.2021, paditësi është zgjedhur Drejtor në shkollën “Dëshmorët e Hereçit” në Hereç për periudhën katër vjeçare. I njëjti është pensionuar me datë 20.07.2023, sipas Vendimit të lëshuar nga e paditura me numëra 01-118/02-11698 i datës 05.06.2023. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Në rastin konkret, paditësi kërkesën e tij e ka mbështetur në nenin 35 par.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në njërën anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në anën tjetër, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Lidhur me këtë kontratë, gjykata vë në dukje që njëra nga palët kontraktuese dhe atë MASHT, përmes njoftimit numër 01B/488 të datës 21.11.2022 ka deklaruar shkëputjen e kontratës së lartcekur, ndërsa pala tjetër kontraktuese SBASHK nuk ka ndërmarrë ndonjë hap në drejtim të kontestimit të shkëputjes së kësaj kontrate. Në rrethana të tilla, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, të punësuarit të institucioneve publike dhe private të arsimit parauniversitar, shtëpitë e studentëve dhe institucionet e arsimit të lartë, mund të kërkojnë realizimin e kërkesave të tyre që rrjedhin nga KKAK, vetëm për periudhën kohore sa ka qenë kjo kontratë në fuqi, pra nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022.

Në këtë rast gjykata ka vërtetuar se paditësi është pensionuar me datë 20.07.2023, pra pas periudhës kur KKAK është shkëputur në mënyrë të njëanshme nga MASHT-i, siç u sqarua më sipër, ashtu që kjo kontratë kolektive nuk prodhon efekt juridik pas datës 21.11.2022, çka do të thotë se paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit sipas kriterëve të lartcekura.

Për këtë arsye, gjykata erdhi në përfundim që kërkesëpadia e paditësit është qartazi e pathemeltë, sepse e njëjta është e pa bazuar në ligj apo akte të tjera nën ligjore në fuqi dhe në mungesë të ndonjë akti tjetër juridik në fuqi që e njeh të drejtën e pretenduar të paditësit, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri sipas nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1503/23, datë 24.04.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.